

Banka e Shqipërisë


2011

Çfarë është Raporti
mbi Kredimarrësin?

Çfarë është Raporti mbi Kredimarrësin?

Raporti mbi kredimarrësin është një dokument i gjeneruar nga sistemi i Regjistrimit të Kredive dhe përmban të dhëna/informacion mbi identitetin e kredimarrësit dhe gjendjen e tij të kreditit në sistemin bankar dhe atë financiar.

Raporti mbi kredimarrësin lëshohet pranë Bankës së Shqipërisë pas kryerjes së kërkesës për kredi nga një person fizik apo juridik. Subjekti kredidhënës gjatë shqyrtimit të aplikimit për kredi, kërkon informacion për çdo aplikant në Regjistrimin e Kredive dhe lexon raportin e tij të kredimarrësit. Aplikanti për kredi nënshkruan “Klauzolën e pëlqimit paraprak”, e cila është pjesë thelbësore e procedurës së aplikimit për kredi.



Credit Report

Credit Report

- Account Details
- Payment History
- Public Records
- Collection Accounts
- Other Information
- Summary

Account Details

Account Name	Account Type	Balance	Status
ABC Bank	Checking	\$1,200.00	Open
XYZ Company	Business	\$500.00	Open
DEF Store	Retail	\$200.00	Open
GHI Finance	Auto	\$15,000.00	Open
JKL Credit	Card	\$800.00	Open
MNO Bank	Savings	\$3,000.00	Open
PQR Bank	Checking	\$1,000.00	Open
STU Bank	Checking	\$2,000.00	Open
VWX Bank	Checking	\$1,500.00	Open
YZA Bank	Checking	\$1,800.00	Open

Payment History

Account Name	Payment Status	Due Date	Amount
ABC Bank	On Time	12/15/2003	\$50.00
XYZ Company	On Time	12/15/2003	\$100.00
DEF Store	On Time	12/15/2003	\$40.00
GHI Finance	On Time	12/15/2003	\$300.00
JKL Credit	On Time	12/15/2003	\$80.00
MNO Bank	On Time	12/15/2003	\$75.00
PQR Bank	On Time	12/15/2003	\$60.00
STU Bank	On Time	12/15/2003	\$120.00
VWX Bank	On Time	12/15/2003	\$150.00
YZA Bank	On Time	12/15/2003	\$180.00

Public Records

Record Type	Amount	Date
Bankruptcy	\$10,000.00	12/15/2003
Judgment	\$5,000.00	12/15/2003
Lien	\$2,000.00	12/15/2003

Collection Accounts

Account Name	Amount	Status
ABC Bank	\$1,000.00	Open
XYZ Company	\$500.00	Open
DEF Store	\$200.00	Open
GHI Finance	\$15,000.00	Open
JKL Credit	\$800.00	Open
MNO Bank	\$3,000.00	Open
PQR Bank	\$1,000.00	Open
STU Bank	\$2,000.00	Open
VWX Bank	\$1,500.00	Open
YZA Bank	\$1,800.00	Open

Other Information

Item	Value	Date
Bankruptcy	\$10,000.00	12/15/2003
Judgment	\$5,000.00	12/15/2003
Lien	\$2,000.00	12/15/2003

Summary

Category	Value
Total Debt	\$25,000.00
Total Assets	\$10,000.00
Net Worth	\$15,000.00

Footnote

SEAR
monthly statement
12/15/2003

1. PËRSE SHËRBEN RAPORTI MBI KREDIMARRËSIN?

Raporti mbi kredimarrësin i krijon mundësinë bankave, subjekteve financiare jobanka dhe unioneve të shoqërive të kursim-kreditit të njihen me historikun e shlyerjes së kredive të një kredimarrësi, duke i ndihmuar ato për një vendimarrje më të mirë në lidhje me kredidhënien. Nëpërmjet Raportit mbi kredimarrësin, subjekti kredidhënës njihet me ekspozimin e aplikantit në sektorin bankar apo financiar dhe është në gjendje të vlerësojë detyrimet e tij financiare, garancitë, performancën dhe besueshmërinë e tij.

2. CILI ËSHTË AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR LËSHIMIN E RAPORTIT MBI KREDIMARRËSIN?

Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm që mund t'i lëshojë Raportin mbi Kredimarrësin kujt do që është i interesuar, në përputhje kjo me rregullat dhe udhëzimet e miratuara për këtë qëllim.

3. CILËT JANË PËRDORUESIT E RAPORTIT MBI KREDIMARRËSIN?

Përdoruesit e Raportit mbi Kredimarrësin janë të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja, që janë të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, si dhe subjektet financiare jobanka që ushtrjnë aktivitetin e kredidhënies dhe unionet e shoqërive të kursim-kreditit në

rolin e përfaqësuesve të shoqërive të kursim-kreditit anëtare të tyre. Gjithashtu, të drejtën e përfitimit të Raportit mbi Kredimarrësin e gëzon edhe vetë kredimarrësi, trashëgimtarët e tij, personi i autorizuar nga ai, si dhe subjektet e tjera, që gëzojnë të drejtën për të kërkuar Raportin mbi kredimarrësin në bazë të një detyrimi ligjor apo të vendimit të gjykatës kompetente.

Kështu, Banka e Shqipërisë nxjerr Raportin mbi kredimarrësin:

- a) mbi bazën e kërkesës të paraqitur nga vetë ky i fundit, nga trashëgimtarët e tij, apo nga një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tyre; mbi bazën e kërkesës së paraqitur drejtpërdrejt nga personat e lidhur me kredimarrësin, garantuesi/t e kredisë, nga trashëgimtarët e tyre ose nga një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tyre;
- b) në përmbushje të një detyrimi ligjor apo të një vendimi të gjykatës kompetente.

Procedura e nxjerrjes nga Banka e Shqipërisë së Raportit mbi kredimarrësin trajtohet në udhëzimin “Për procedurën e nxjerrjes së Raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive” miratuar me vendimin nr. 68, datë 13.10.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

4. ÇFARË INFORMACIONI PËRMBAN RAPORTI MBI KREDIMARRËSIN?

Raporti mbi kredimarrësin përmban:

- A. Të dhëna të përgjithshme mbi kredimarrësin - datën e regjistrimit të tij të parë në Regjistrin e Kredive, adresën, numrin e telefonit, si dhe:
- emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, numrin e dokumentit të identifikimit, nëse kredimarrësi është individ;
 - emrin e shoqërisë, datën e saj të regjistrimit, numrin e regjistrimit dhe statusin e saj ligjor, nëse kredimarrësi është person juridik.
- B. Informacion financiar mbi kredimarrësin

Informacioni financiar përfshin të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të dhënë kredimarrësit, si dhe të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të, në të cilat kredimarrësi shfaqet si person i lidhur¹ dhe/ose si garantor (më poshtë për thjeshtësi referuar si person i lidhur).

Në qoftë se është subjekti raportues që kryen kërkimin në sistem, atëherë do të shfaqet emri i raportuesit dhe në vazhdim do të radhiten të dhënat financiare të kredimarrësit, në këtë subjekt që po kryen kërkimin. Njëkohësisht, ekspozimi

¹ Person i lidhur – përkufizohet sipas nenit 4, pika 1.9, e ligjit nr. 9662 dt. 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

i klientit në subjektet e tjera, shfaqet njëloj si më lart, por pa cilësuar emrin e raportuesit/ve të tjerë ku personi mund të ketë kredi.

Të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të që i janë akorduar kredimarrësit, përfshijnë:

1. **Llojin e kredisë** – njëri nga 7 alternativat, shprehur me kodet përkatëse: 0 - kredi; 1 - overdraft; 2 - kartë krediti; 3 - letër krediti; 4 - garanci; 5 - të tjera; 6 - qira financiare.
2. **Datën e disbursimit të kredisë** – data në të cilën, fondet janë transferuar për llogari të kredimarrësit.
3. **Shumën e miratuar të kredisë** – shuma totale, për të cilën banka është angazhuar të financojë kredimarrësin.
4. **Shumën e disbursuar të kredisë** – mund të jetë më e vogël ose e barabartë me shumën e miratuar të kredisë.
5. **Këstin mujor** – madhësia mesatare e detyrimit mujor të kredimarrësit për një kredi të caktuar.
6. **Tepricën e kredisë** – gjendja e detyrimit të kredimarrësit në datën e nxjerrjes së raportit, pas zbritjes së pagesave të kryera dhe shtimit të interesave të përlogaritura.
7. **Shumën e vonuar** – pasqyron detyrimin e papaguar në kohë të kredimarrësit.
8. **Monedhën/Valutën** – njëri prej 7 alternativave, shprehur me kodet përkatëse: 0 - lek; 1 - euro; 2 - usd; 3 - GbP; 4 - Yen; 5 - Chf; 6 - të tjera.
9. **Statusin e klasifikimit** – njëri prej 8 alternativave, shprehur me kodet përkatëse: 0 - standarde; 1 - në ndjekje; 2 - nënstandarde; 3 - e dyshimtë; 4 - e humbur;

5 - e paguar; 6 - e fshirë nga bilanci; 7 - e anuluar.

10. **Historikun e klasifikimit** – pasqyron klasifikimin e kredisë për 12 periudhat më të fundit, duke filluar nga periudha aktuale.

11. **Kolateralin** – pasqyron tërësinë e kolateraleve të ndarë në rreshta, ku për secilin raportohet:

- numri serial i kolateralit – për pasuritë e patundshme raportohet: numri i pasurisë ose numri i hipotekës dhe/ose numri i regjistrimit dhe/ose numri i faqes; për mjetet e transportit raportohet numri i shasisë; për makineri/ pajisje raportohet numri i shasisë së linjës së prodhimit.
- lloji i kolateralit – njëri prej 7 alternativave, shprehur me kodet përkatëse: 0 - hipotekë; 1 - inventar; 2 - makineri dhe pajisje; 3 - veturë; 4 - depozitë në “cash”; 5 - të tjera; 6- objekt i kontratës së qirasë financiare.
- përshkrimi i kolateralit - tekst i lirë, përshkrim i shkurtër i kolateralit.

Në vazhdim, Raporti mbi kredimarrësin pasqyron një përmbledhje të totalit të kredive dhënë kredimarrësit, duke prezantuar numrin total të këtyre kredive, së bashku me disa prej të dhënave të mësipërme financiare (konkretisht të dhënat nr: 3; 4; 5; 6 dhe 7).

Të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të, në të cilën/cilat kredimarrësi shfaqet si person i lidhur, përfshijnë:

- tërësinë e informacionit financiar trajtuar për kredinë/të, të cilat i akordohen kredimarrësit, si dhe
- rolin e kredimarrësit si person i lidhur – njëri ose disa prej alternativave, shprehur

me kodet përkatëse: 0 - garantues; 1 - bashkëshort; 2 - drejtor; 3 - pronar/ aksioner; 4 - bashkëkredimarrës; 5 - firmë e lidhur.

Në vijim, Raporti mbi kredimarrësin pasqyron një përmbledhje të totalit të kredive që i janë akorduar kredimarrësit dhe totalit të kredive, në të cilat ai shfaqet si person i lidhur, duke prezantuar numrin total të këtyre kredive, së bashku me disa prej të dhënave financiare (konkretisht të dhënat nr: 3; 4; 5; 6 dhe 7).

Gjithashtu, Raporti mbi kredimarrësin radhit pesë kërkimet më të fundit mbi kredimarrësin sipas datës përkatëse dhe emrit të subjektit kredidhënës, pjesëmarrës në Regjistrin e Kredive.

Së fundi, mbështetur në të drejtën e kredimarrësit për të kërkuar rishikimin e të dhënave të tij që mbahen në Regjistrin e Kredive (neni 11, i udhëzimit “Për procedurën e nxjerrjes së Raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive” miratuar me vendimin nr. 68, datë 13.10.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë), kërkesa për rishikimin e Raportit mbi kredimarrësin përmban edhe një hapësirë me qëllim shpjegimin e detajuar të saj. Ky tekst plotësohet në rast se, pas verifikimit të kryer mbi saktësinë e të dhënave të kredimarrësit, konfirmohet se informacioni është i saktë, por vetë kredimarrësi këmbëngul se informacioni është i pasaktë apo i paplotë. Në këtë situatë, kredimarrësi dorëzon pranë Regjistrin të Kredive një dokument me shkrim, në të cilin shpjegon arsyet pse ai pretendon se informacioni është i pasaktë apo i paplotë. Pretendimi i kredimarrësit bashkëshoqëron Raportin mbi kredimarrësin në çdo çast të trajtimit të tij.

Më poshtë, jepet një shembull i Raportit mbi kredimarrësin:

RAPORTI MBI KREDIMARRËSIN

Të dhëna të përgjithshme.

Emri, Atësia, Mbiemri	Datëlindja	Nr. i Dokumentit të Identifikimit
Denald Ahmet Tomorri	30.03.1978	Z 27289685

Personi juridik

Nr. i dokumentit të identifikimit

Emri i Kompanisë	Data e Regjistrimit	Numri i Regjistrimit	Statusi Ligjor
Siemens sh.a	10.10.2005	802895	Shoqëri aksionere

Nr. i regjistrimit

Statusi ligjor

Data e regjistrimit të parë në Regjistrin e Kredive	Adresa	Nr. telefonit
08.2005	Rr. "Sami Frashëri", 155, Tiranë	213455

Në raportuesin (emri i raportuesit që kryen kërkimin në bazën e të dhënave.)

Lloji i kredisë	Data e disbursimit*	Shuma e aprovuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar	Monedha	Statusi i klasifikimit
0	10.02.2007	10 000	10 000	220	8 000	0	0	1
Historiku i klasifikimit		000						
Kolaterali 1		01231		0		Apartament 1 + 1		
Kolaterali 2		32 0222		3		Veturë benz		
1	22.04.2006	1000	500	-	502	-	0	0
Historiku i klasifikimit		00001111000011111						
Kolaterali		212 00		4		Depozitë në "cash"		

Në raportuesit e tjerë:

Lloji i Kredisë	Data e disbursimit*	Shuma e miratuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar	Monedha	Statusi i klasifikimit
0	08.03.2006	20 000	20 000	320	15 000	350	0	1
Historiku i klasifikimit		11110011112221111000						
Kolaterali 1		4523		0		Apartament 2+1		
0	10.08.2005	15 000	15 000	125	10 000	0	0	1
Historiku i klasifikimit		111100000011112221111000						
Kolaterali 1		0230		2		Makineri për prodhimin e pajisjeve metalprerëse		

Ekspozimi i kredimarrësit në sistem (në lekë).

Numri total i kredive	Shuma totale e miratuar	Shuma totale e disbursuar	Shuma totale e kësteve mujore	Teprica totale e kredisë	Shuma totale e vonuar
4	46 000	45 500	665	35 502	350

** Radhitja e kredive të akorduara do të prezantohet sipas datës më të fundit të disbursimit, domethënë do të radhitet e para kredia e disbursuar në datën më të fundit.*

Kredimarrësi si person i lidhur:

Në raportuesin/në XXX:

Roli	Lloji i kredisë	Data e disbursimit*	Shuma e miratuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar	Monedha	Statusi i klasifikimit
1;4	0	29.05.2006	20 000	20 000	150	12 000	0	0	0
Historiku i klasifikimit			000001111000011000						
Kolaterali 1			2523		0		Apartament 1+ 1		
3	0	09.10.2005	20 000	20 000	250	15000	0	0	0
Historiku i klasifikimit			0000111100001111000000						
Kolaterali 1			3562		0		Apartament 2+ 1		

Madhësia totale e ekspozimit të kredimarrësit në sistem, përfshirë dhe kreditë, në të cilat ai shfaqet si person i lidhur (në lekë).

Numri total i kredive	Shuma e miratuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar
6	81 000	80 500	1 065	60 502	350

Pesë kërkimet më të fundit mbi kredimarrësin:

Data e kryerjes së kërkimit	Emri i raportuesit (do të shfaqet)
29.12.2010	Fondi Besa
22.06.2010	Banka e Tiranës
02.10.2009	Banka Raiffeisen
15.02.2009	Banka e Tiranës
18.05.2008	Banka Credins

Banka e Shqipërisë

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

*Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Avni Rustemi" Nr.24, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408*

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 7000 kopje